



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:128176

Datë: 23.04.2021

Numri i dokumentit: 01725913

**C.nr.228/19**

**GJYKATA THEMELORE NE PEJË - DEGA NE ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, sipas gjyqtarit Shemsedin Haxhiaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit K. (L.) F. nga fsh.....K-.... , i përfaqësuar nga P. U. avokate nga Istogu, kundër të paditurës Komuna e Istogut – Drejtoria e Shëndetësisë, përfaqësuar nga avokati Publik Komunal A. A. nga Istogu, nga baza juridike: kompensim i pagave përcjellëse në pension dhe shpërblim jubilar, vlera e kontestit 2,200.00 Euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor nën prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse me datë 07.04.2021, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K. (L.) F. nga fsh. ....K-....., dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Istogut – Drejtoria e Shëndetësisë, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t’ia paguaj 1(një) pagë dhe atë në shumën prej 470 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë 17.06.2019 e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.
- II. REFUZOHET** si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e gjykuara, dhe atë në emër të kompensimit të dy pagave përcjellëse t’ia paguaj shumën prej 940 €.
- III. Detyrohet** e paditura Komuna e Istogut – Drejtoria e Shëndetësisë, që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 270 €.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes te autorizuarit te tij në padi si dhe me precizimin e kërkesëpadisë të bërë në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 07.04.2021, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Istogut – Drejtoria e Shëndetësisë që paditësit K. (L.) F., në emër të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, t’ia kompensoj (2) dy paga mujore në shumën prej 940 Euro, dhe një pagë në emër të shpërblimit jubilar shumën në lartësi prej 470 Euro, dhe atë në shumë të përgjithshme prej **1,410 €**, me kamatë ligjore prej 8 %, nga momenti i paraqitjes se padisë, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

E autorizuar e paditësit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se, qëndron ne tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, si dhe precizimit te padisë edhe pas kundërshtimit te autorizuarit te paditurës i kundërshtojmë ne tërësi pretendimet e te paditurës, pas leximit te provave qe gjenden ne shkresat e lendes konsiderojmë qe padia e paditësit është e bazuar dhe kërkojmë nga gjykata qe kërkesëpadia te aprovohet ne tërësi dhe paditësit ti mundësohet kompensimi i dy pagave përcjellëse dhe një page jubilarë ashtu siç kemi cekur edhe ne precizimin e padisë me kamatën ligjore prej 8 % nga momenti i ngritjes se padisë dhe atë 15 dit nga plotfuqishmëria e aktvendimit. Ndërsa sa i përket shpenzimeve procedurale kërkojmë kompensimin dhe atë 104 € për padi, dhe dy seanca nga 135 €, ne shume totale prej 374 €.

I autorizuari i te paditurës ne përgjigjen ne padi, gjate shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se, sa i përket faktit te rregullsisë se sajë nga se paditësi edhe përkundër paralajmërimeve nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 24 te Ligjit për ndryshim plotësim te ligjit 03/L- 048 për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë nuk është precizuar ne aspektin objektiv nga se prape bazën e ka lënë te njëjtë ne rregullore te brendshme. Sa i përket legjitimitimit pasiv ajo është precizu ne mënyrë te plote. Paditësit me aktvendim i është njohtë e drejta ne një page përcjellëse me kërkesën e tij, nuk kemi te dhëna qe aktvendimi i ti është kontestu e as ankimi për këtë konsideroj se me pranim paditësi është pajtu me shpërbllimin e dhënë. Sa i përket provave qe ia bashkëngjit ato asnjëra prej tyre nuk janë origjinal dhe as qe i janë prezantuar për verifikim për këtë edhe rregullsia e provave te prezantuara është kontestuese.

Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se dispozitat ne mënyrë taksative obligojnë paditësin qe provat te cilat i prezanton ti dorëzoj gjykatës ne origjinal, asnjëra prej tyre nuk është prezantua ne gjykate e as për palën e paditur ne mënyrë te rregullt. Për këtë edhe konsideroj te dyshimte këtë forme te procedimit. Sa i përket propozimit me te cilin bije aktvendim për pezullim një vendim i tille bije ne kundërshtim me nenin 68 te Ligjit per menagjimin e financave nga se para. 2 ne mënyrë taksative i obligon gjykatat qe mos te ndërmarrin asnjë veprim pa u përmbush kërkesat e caktuara me këtë ligj. Sa i përket kërkesës për pagë jubilarë ajo nuk është precizua ne harmoni me kontrate kolektive, një propozim i tillë është ne kundërshtim me ligjin për buxhetin nenin 2 dhe qarkoren buxhetore te Republikës se Kosovës ne te cilat shprehimisht është definua se buxheti munde te shfrytëzohet vetëm për destinacionin e dedikuar, kontrata kolektive sektoriale është nënshkrua ne mes te Ministrisë te Shëndetësisë se Qeverise se Republikës se Kosovës e jo Komunës se Istogut e cila as qe është pale kontraktuese. Për këtë as qe është aloku buxhet e as qe janë percaktu kostot buxhetore për hartimin dhe përmbushjen e obligimeve qe rrjedhin nga kontrata kolektive, për këtë konsideroj se kësaj padie i mungon baza juridike. Sa i përket shpenzimeve procedurale ne shumen e precizuar ato janë shkaktua me vet fajin e palës paditëse nga se seancat e mbajtura janë si pasoje e parregullsisë se padisë se paraqitur ne aspektin subjektiv dhe objektiv nuk janë shkaktua me fajin e palës se paditur për këtë dhe e kontestojmë. Sa i përket kamatës dhe e njëjta kundërshtohet nga se paditësi me asnjë kërkesë te vetme nuk i është drejtu institucionit i cili ne mënyrë te rregullt i ka përmbush te gjitha obligimet ndaj paditësit sa ka qene ne mardhenjë pune. Shpërbllimet jubilarë paguhen me rastin e arritjes se jubileut ne kohen e caktuar për këtë mendoj se ka ardhe deri te parashkrimi i një kërkesë te tille. Shpenzimet procedurale nuk i kërkoj.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: kontrata e punës me nr.911 e dt.13.10.2014 e lidhur ne mes paditesit dhe QKMF-se –Istog, aktvendimi per përfundimin e punësimit per paditësin tge lëshuar nga QKMF-GCPM- MCFM me nr.232 dt.29.03.2019 ne te cilin vendim eshte cekur edhe vitet e punës se paditësit, qarkullimi bankar për paditësin për periudhën kohore 01.03.2016 -

19.04.2019 lëshuar nga banka BPB me dt.13.06.2019, njoftimi me nr.ref.06 nr.143/2020 lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ne Istog, lista e pagave te lëshuar nga e paditura për paditësin dt.01.03.2019, lista e pagave te lëshuar nga e paditura për paditësin dt.01.02.2019, lista e pagave te lëshuar nga e paditura për paditësin dt.01.04.2019.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, pasi vërtetoi ketë gjendje faktike:

Nga kontrata e punës me nr. 911 dt. 13.10.2014, vërtetohet fakti se paditësi me te paditurën këtu Qendren e Mjekësisë Familjare në Istog, kanë lidhur kontrate pune me detyra të punës si mirëmbajtës.

Nga aktvendimi për përfundimin e punesimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore QKMF-GCPM-MCFM me nr.232 të datës 29.03.2019, vërtetohet fakti paditësit i ndërprehet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore në vendin e punës si mirëmbajtës në QKMF-Istog, me dt. 29.03.2019 për shkak të mbushjes se moshës mandatorë te pensionimit që është gjashtëdhjetë e pese (65) vjeç. Paditësi ka qene i punësuar tek e paditura për 18 (tetëmbdhjet) vite, 3 (tre) muaj, dhe 4 (katër) ditë pervoje pune.

Nga njoftimi me nr. 06 nr.143/2020 gjykata vertetoi se e paditura i ka kthyer përgjegje në kërkesën për shpërblim jubilar dhe paga përcjellse, nga arsye se nuk ka mjete të alokuar për ketë kategori për vitin 2019 dhe 2020.

Nga lista e pagave te lëshuar nga e paditura për paditësin dt.01.02.2019 gjykata ka vërtetuar se të ardhurat nga paga për paditësin për periudhën e fundit për paditësin ka qenë në shumën prej 470 euro.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura me pune dhe detyra të punës si mirëmbajtës, në QKMF-Istog.

Nuk ishte kontestues se paditësi kishte 18 (tetëmbdhjet) vite, 3 (tre) muaj, dhe 4 (katër) ditë pervoje pune.

Nuk ka qenë kontestuese ne mes ndërgjyqësve se paditësi ka pranuar një pagë përcjellëse me rastin e pensionimit nga e paditura në shumën prej 470 euro.

Nga provat e administruara si më lartë, gjykata gjeti se paditësi kishte punuar te e paditura për 18 (tetëmbdhjet) vite, 3 (tre) muaj, dhe 4 (katër) ditë pervoje pune, të njëjtit nuk i është paguar pagesa për shpërblim jubilar në vlerë të një page bazë, të parapara me nenin 17 par. 3 pika 3.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS). Mos pagesën e kësaj page edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor e pohoi e paditura, e cila ka pohuar se të njëjtat nuk i takojnë. Lartësinë e pagesën mujore neto në shumë prej 470 €, gjykata e vërtetoi nga lista e pagave të paditëses.

Gjykata duke ju referuar KKS, të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 17 par. 3 pika 1, sipas të cilit *Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i*

*fundit në vlerë [...] Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page mujore të tij.*

Gjykata vlerësoi se Kontrata Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë (KKS) është e aplikueshme në rastin konkret, e njëjta ka hyrë në fuqi me 11.06.2018 dhe është e zbatueshme për tre vite nga lidhja e sajë. Në nenin 17 par. 4 të KKS parashihet se *Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*

Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, i njëjti është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve *Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.* Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën si në dispozita të aktgjykimit.

Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke gjetur si të bazuar kundërshtimin nga e paditura, ashtu që ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë përtej shumës nga pika një e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë, në emër të pagesës së dy pagave përcjellës, të detyrohet e paditura të paguaj paditësit shumën prej 940 €, pasi që gjykata e vlerësoi se paditësit i takojnë një pagë përcjellëse të cilën e ka pranuar dhe ka mbetur vetëm paga jubilarë, krejt kjo duke iu referuar përvojës së punës 18 vjeqre. Për të bërë përkufizimin se çka nënkupton *pagë* dhe *pagë shtesë*, gjykata vë në dukje përcaktimin ligjor nga Ligji i Punës i cili në nenin 55 par. 2, thotë se i punësuari ka të drejtë *për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.* Pra ky përcaktim ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë, dhe shtesa nga paga. Kurse në anën tjetër, neni 17 par. 3 pika 3.1 i KKS-së, thotë i punësuari ka të drejtë e realizimit e një pagae mujore, e që nuk i përfshinë shtesat tjera nga paga. Pra shtesat tjera nga paga, duke përfshirë bonuset etj., të punësuarit i takojnë kur ai gjatë angazhimit në detyra të punës arrin të realizoj shtesat në ushqim, punë jashtë orari etj.

Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka linjë buxhetore të ndarë për pagesën e pagave jubilarë i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësi në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton KKS, kurse mungesa e buxhetit të të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pretendimin tjetër të paditurës se nuk janë nënshkruese të kësaj kontrate, gjykata vë në dukje se Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, kanë marrë përsipër që për stafin shëndetësor të rregullohen raportet që parashihen me këtë kontratë. Në kuptim të kësaj, të punësuarit në sektorin e shëndetësisë nuk mund të vlerësohen ndaras, porse ata paraqesin të punësuar në një sistem unitar të shëndetësisë, duke përfshirë nivelin qendror dhe lokal. Prandaj pretendimi për t'iu shmangur pagimit të obligimeve të marra përmes KKS, do të ishte në kundërshtim me atë që është zotuar MSH.

Gjykata ka vlerësuar edhe prapësimet tjera procedurale dhe materiale të dhëna nga i autorizuari i të paditurës por të njëjtat ishin pa ndikim në vendosje ndryshe.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitor, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë. Kjo çështje kontestuese tërheq të drejtën e kreditorit të kërkojë kamatën, e llogaritur nga dita e paraqitjes së kërkesës pasi të jetë arritur për pagesë kredia. Mirëpo në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi paditësi të ketë kërkuar nga e paditura në rrugë jashtëgjyqësore pagesën e këtyre pagave, së këndejmi është vendosur që kamata të gjykohet nga dita e parashtrimit të padisë (në këtë mënyrë edhe Mendimi juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i dt.02.12.2020).

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 270, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për dy seanca secilën në shumë prej 135 euro, sipas tarifës së OAK-së. Ndërsa shumën prej 104 euro të kërkuar për përpilim të padisë gjykata e refuzoi si të pa bazuar ngase nuk ka dëshmi të është përpiluar tek avokati.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.228/19, datë 07.04.2021**

**Gjyqtari**

\_\_\_\_\_  
Shemsedin Haxhiaj

**Udhëzim juridik** : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.